

Возраст  
Контакт  
Перцепции

Age  
Contact  
Perceptions

Yaş  
Temas  
Algilama

Mosha  
Kontakti  
Perceptimet

OSCE AGE - CONTACT - PERCEPTIONS How schools shape relations between ethnicities



# Mosha Kontakti Perceptimet

Si Shkollat I Ndërtojnë  
Marrëdhëniet  
Mes Bashkësive

Janar 2010

# Përmbajtje

Faleminderim.....	76
Parathënie .....	77
Metodologjia.....	78
Instrument .....	78
Shembull.....	78
Sqarime metodologjike.....	79
Rezultate .....	80
Qëndrime ndaj bashkësive të ndryshme etnike.....	80
Moshë e formimit të vetëdijes për grupe të ndryshme etnike .....	80
Faktorë të formimit të vetëdijes për grupet etnike .....	81
Ndjenja ndaj bashkësive të tjera etnike .....	81
Ndjenja pozitive .....	82
Zhvillim të ndjenjave pozitive .....	83
Dallime rajonale.....	83
Dallime gjinore.....	83
Ndjenja negative .....	83
Zhvillim i ndjenjave negative .....	84
Dallime rajonale.....	85
Dallime gjinore .....	85
Shpeshtia e kontaktit me bashkësitë e tjera etnike .....	85
Shpeshtia e kontaktit dhe ndjenja ndaj bashkësive të tjera etnike .....	86
Dallime rajonale në shpeshtinë e kontaktit .....	86
Shkolla dhe marrëdhëniet ndëretnike.....	87
Faktorë nga shkolla të cilët ndikojnë në formimin e qëndrimeve për bashkësitë etnike .....	87
Mësues.....	87
Bashkënxënës.....	88

Libra shkollor .....	88
Shkaqe për armiqësi mes nxënësve nga përkatësia e ndryshme etnike në shkollat .....	89
Roli i shkollës në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike .....	90
Studim i rastit – Strugë .....	92
Përundim .....	93
Rekomandime për aktivitetet dhe hulumtimet e ardhëshme.....	94
Artikuj .....	95
ARTIKULLI 1 - PYETËSOR .....	95
ARTIKULLI 2 - LISTA E SHKOLLAVE.....	97
ARTIKULLI 3 - TABELA.....	99

# Parathënie

Këtë studim e punoi Departamenti pranë Misionit të OSBE-së në Shkup. Qëllimi i këtij studimi është që të mundësoj kuptim më të mirë të perceptimeve dhe sjelljeve të cilat dominojnë mes gjimnazistëve në relacion me moshatarët e tyre nga grupet tjera etnike. Studimi u mundësoi të rinjve ti shrehin pikëpamjet e tyre për një landë e cila i ngarkon ata në mënyrë direkte, mirëpo deri më tani është diskutuar vetëm nga të rritur. Gjithashtu, projektet, programet dhe praktikat në këtë fushë ishin të zhvilluara dhe implementuara, në masë të madhe, duke mos u marrë parasysh qëndrimet dhe pikëpamjet e grupit cak. Ky studim është hapi i parë në drejtim të kuptimit më të detajuar të gjendjes momentale.

Misioni i OSBE-së në Shkup.  
Departamenti për arsim

Shkup, Janar 2010

# Faleminderim

Ky studim është desajnuar nga Johann Schustereder, Referent Zhvillimor i Arsimit dhe Emilija Simonovska-Janaçkovska, Asistent Programor për Arsim në Misionin e OCBE-së në Shkup. Të dhënat dhe thurja e analizave u kryen nga ana e Qendrës për Hulumtim dhe Krijimin e Politikave.

Ekipi Arsimor i OSBE-së e shpreh faleminderimin e tij ndaj Ministrisë për Arsim dhe Shkencë dhe drejtorëve të shkollave për përkrahjen e tyre aktive. Ekipi Arsimor gjithashtu u faleminderohet përkthyesve Zlata Brajovik dhe Jessica Mangskau (Përkthimi anglisht), Skender Mehmeti (Përkthimi shqip) dhe Meral Asimov (Përkthimi turqisht) si dhe kolegëve në Misionin e OSBE-së i cili e bëri studimin të mundshëm.

Të drejta,  
Misioni mbikqyrës i OSBE-së në Shkup  
Ndërtesa e Kjubit, Shkup  
11 Tetori nr. 25

[Osce.org/skopje](http://Osce.org/skopje)

# Metodologjia

## Instrument

Instrumenti themelor për grumbullimin e të dhënave ishte **pyetëtori** (shif artikuli 1) i përbërë nga 18 pyetje, prej të cilave tre demografike. Pjesa e parë e pyetëtorit i përket qëndrimeve të nxënësve ndaj grupeve tjera etnike, duke i kyqur edhe moshën dhe faktorët e formimit të qëndrimeve të këtylla. Pjesa e dytë ka për qëllim të kontrollojë mendimet e nxënësve për mënyrat me të cilat shkollat i trajtojnë dallimet etnike, si dhe arsyet për mosmarrëveshjet në shkollat të ngjara mbi baza etnike.

Para se ti jepet shembullit të planifikuar, pyetëtori u pilotua 60 nxënësve (maqedonas dhe shqiptarë) nga një qytet me qëllim të vertetohet kuptueshmëria e pyetjeve). Mbi bazën e komenteve të nxënësve, një pjesë e pyetjeve u modifikuan.

**Përpunim i të dhënave** u krye në SPSS pako, me çrast u analizua relacioni mes faktorëve në shkollën (mësues, bashknxënës, libra e të ngjashme) me shpeshinë e kontaktit dhe qëndrimeve të grupeve të ndryshme etnike. Analiza e të dhënave është paraqitur ndaras për nxënësit maqedonas, shqiptarë dhe turq, derisa të pyeturit nga grupet e tjera etnike për shkak të pamjaftueshmërisë në numër të jenë të analizuar ndaras, janë të grupuar dhe vendosura në kategori – tjerë.

## Shembull

Shembulli kaploi 4032 nxënës-gjimnazistë nga viti i dytë dhe tretë nga 40 shkolla të mesme nëpër Maqedoni (shikoe listën e shkollave në artikullin 2). Gjatë zgjedhjes së shkollave mbaheshte kujdes për kyqjen e llojeve të ndryshme të shkollave (gjimnaze, shkollave të mesme profesionale dhe artistike), me qëllim që të ndërtohen kategori të ndryshme të nxënësve. Hulumtimi në teren u krye gjatë periudhës prej 1 deri në 5 qershor, të vitit 2009.

Anketuesit u jepnin pyetëtorët rreth 100 nxënësve (gjegjësisht 3-4 klasave) nga çdo shkollë, duke patur kujdes për përfaqësinë e nxënësve nga bashkësi të ndryshme etnike.

Pyetëtorët jepeshin në tre gjuhë (maqedonisht, shqip dhe turqisht), në përputhje me gjuhën mësimore të të pyeturve.

### Karakteristikat e pyetëtorit janë vijueset:


Shembulli është relativisht barabartë i shpërndarë sipas **përkatësisë gjinore**, 50.3% janë meshkuj, 48.4% femra, derisa të tjerë nuk janë deklaruar.

Qyteti	Numri	%
Shkup	601	14,9
Kumanovë	204	5,1
Kratovë	97	2,4
Kriva Pallankë	100	2,5
Sveti Nikole	100	2,5
Shtip	199	4,9
Radovich	100	2,5
Strumicë	95	2,4
Vallandovë	98	2,4
Veles	200	5,0
Negotinë	110	2,7
Krushevë	102	2,5
Prilep	200	5,0
Manastir	300	7,4
Resnjë	100	2,5
Demir Hisar	101	2,5
Ohër	200	5,0
Strugë	218	5,4
Kërçovë	96	2,4
Dibër	100	2,5
Makedonski Brod	109	2,7
Gostivar	140	3,5
Tetovë	462	11,5
Gjithsej	4032	100,0

Numri i të pyeturve nëpër qytete është i përcaktuar varësisht nga numri i shkollave të mesme në çdo qytet dhe përputhet me numrin e popullatës në këta qytete.

Përqindja e të pyeturve sipas **përkatësisë etnike** (Grafikoni 1) në numër të madh përputhet me fotografinë etnike të popullatës, posaçërisht në pikëpamje të përfaqësisë së nxënësve nga përkatësia etnike maqedonase,

Grafikon 1: Distribucioni etnik i të pyeturve



shqiptare dhe turke. Problemi më i madh ishte të anketohen numër i përshtatshëm gjimnazistë romë, për shkak të përfaqësimit të dobët të tyre në arsimin e mesëm. Për këtë, numri i përgjithshëm i të pyeturve romë është 18 ose 0.4% nga i tërë shembulli.

## Sqarime metodologjike

Treguesit themelorë statistikorë të cilët ishin të përdorur në analizën e të dhënave janë:

**Përqindje dhe krostabulacione**, përmes përlogaritjes së dallimeve statistikore në distribuimin e të dhënave.

Çdokund gjatë tekstit ku përmendet ekzistimi i dallimeve, mendohet në **dallime domethanëse statistikore**. Ajo do thotë se distribuimi konkret i rezultateve nuk është paraqitur rastësisht dhe në popullatën prej nga është nxjerrë shembulli gjithashtu ekziston dallim në distribuimin e variablave të ndryshme. Për shembull dallimi mes përgjigjeve të maqedonasve dhe shqiptarëve në pyetjen vallë grupi i tyre etnik

është paraqitur në mënyrë të përshtatshme në librat shkollorë nuk është paraqitur si rezultat i rastësisë, por me nivel të lartë të mundësisë (prej 99% ose 95%) pritet e njëjta të ekzistoj në popullatën e gjimnazistëve maqedonas dhe shqiptarë.

Me qëllim të vërtetimit të lidhshmërisë mes variablave të caktuara u përdor **Hi katror (X<sup>2</sup>) teksti** i cili shërben për vërtetimin e pavarësisë së 2 variablave, gjegjësisht vallë ato janë të lidhura dhe bashkarisht dallojnë. Për shembull vallë kontakti më i shpeshtë i maqedonase dhe shqiptarëve është i lidhur me pasjen e ndjenjave pozitive ndaj të njëjtit ose nuk ekziston lidhshmëri.

Gjatë hulumtimit u paraqitën disa probleme metodologjike, për tejkalimin ose minimizimin e të cilave u ndërmorrën masa përkatëse. Së pari, **tematika e ndjeshme** e hulumtimit paraqiste kërcënim për validitetin e përgjigjeve, duke e pasur parasysh se nga nxënësit u kërkua të shprehin ndjenja negative ndaj grupit të caktuar etnik, në periudhë të tenzive të larta etnike

në bashkësi të caktuar. Me qëllim të zmadhimit të sinqeritetit të përgjigjeve të nxënësve u bënë përpjekje për dhënien e pyetësorëve në gjuhën e tyre mësimdhënëse ( e cili më së shpeshti është edhe amtare), si dhe angazhimin e anketuesve të cilët e flasin gjuhën përkatëse. Në atë mënyrë, u krijua atmosferë e siguritetit në „grupin e vetë“, me qëllim të shprehjes më të lirshme të qëndrimeve.

Edhe pse pjesa më e madhe e pyetjeve në pyetësin janë të tipit të mbyllur, dy (pyetje 3 dhe 5) janë të mbyllura, që të zvogëlohet kahëzimi i nxënësve ndaj alternativave të caktuara dhe që të inicohen përgjigjet e tyre spontane. Megjithatë, për një pjesë prej tyre kjo paraqiste vështirësi, posaçërisht për shkak të faktit se nga ata kërkohej konkretisht të tregojnë grupe etnike ndaj të cilave kultivojnë ndjenja negative.

## Rezultate

### Qëndrime ndaj bashkësive të ndryshme etnike

Pjesa e parë e pyetjeve kishin për qëllim ti hulumtojnë faktorët kryesorë të ndikimit mbi formimin e vetëdijes ndaj grupeve të ndryshme etnike në vend, ndjenjat pozitive dhe negative ndaj bashkësisë të caktuar, si dhe moshën e zhvillimit të ndjenjave të këtylla. Gjithashtu, qëllimi ishte të vërtetohet lidhmëria e shpeshtësisë së kontakteve ndaj bashkësive të caktuara me ndjenjat pozitive dhe negative ndaj të njëjtave.


### Mosha e formimit të vetëdijes për grupe të ndryshme etnike

Në përgjithësi, të pyeturit janë përgjigjur se kanë kuptuar për ekzistimin e grupeve etnike të ndryshme në periudhën e shkollës fillore (6-9 dhe 10-14 vjet). Të pyeturit nga kombësia turke në numër të konsiderueshëm janë përgjigjur se kanë zhvilluar vetëdije në moshë 2-5 vjeçare në krahasim me ata nga kombësia maqedonase dhe shqiptare, derisa të dytë në numër më të madh se turqit janë deklaruar se e kanë zhvilluar vetëdijen në periudhën mes moshës

Gjithashtu, gjatë përpunimit të të dhënave u vërejtën lëshime të cilat mesiguri dalin nga **leximi jokonsekuent i instruksioneve** nga ana e nxënësve. Për shembull, edhe pse në një pjesë të pyetjeve është theksuar se nuk duhet ta shkruajnë grupin etnik të tyre, një pjesë e vogël e të pyeturve janë përgjigjur përkundër udhëzimeve. Megjithatë, duke e pasur parasysh se përqindja e tyre është më e vogël se 5, validiteti i të dhënave nuk është vënë në pyetje.


Në fund, janë të mundshme paqartësi në **kuptimin e pyetjeve dhe koncepteve të caktuara**, si për shembull: avancimi aktiv i marrëdhënieve pozitive ndëretnike, vetëdije për grupet e ndryshme etnike, kontakt i rallë dhe i shpeshtë, e të ngjashme. Me qëllim të zvogëlimit të moskuptimeve dhe unifikimit sa më të madh të domethënies së terminologjisë, anketuesit ishin të trajnuar tua sqarojnë pyetjet dhe konceptet nxënësve gjatë plotësimit të pyetësorit, nëse ajo kërkohet nga ata.

**Grafikon 2: Mosha dhe vetëdija e grupeve etnike**



10-14 vjeçare (shiko Grafikon 2 dhe tabela 1 në artikullin 4).

**Grafikon 3: Faktorët që ndikojnë në vetëdijen e grupeve etnike**



### Faktorë të formimit të vetëdijes për grupet etnike

Për tërë shembullin, faktor më me ndikim për formimin e vetëdijes ndaj grupeve të ndryshme etnike janë prindët (28%), pasojnë mediat (23.7%) dhe miqtë (22.1%) (Grafikoni 3). Megjithatë ekzistojnë dallime të rëndësishme në domethanien e këtyre faktorëve tek nxënësit nga etnikume të ndryshme. Dhe kështu, numër më i madh i nxënësve shqiptarë, prindët dhe mësuesit i vlerësojnë për të më rëndësishëm se sa maqedonasit dhe turqit. Nga ana tjetër, për numër më të madh të nxënësve maqedonas mediat janë faktor i rëndësishëm në krahasim me shqiptarët dhe turqit. Dhe në fund, nxënësit turq në numër më të madh i vlerësojnë miqtë për faktor të rëndësishëm në

krahasim me maqedonasit dhe shqiptarët. Mes faktorëve tjerë, nuk ka dallime të rëndësishme mes grupeve etnike. Bashknxënësit dhe librat shkollorë, sipas mendimit të të gjithë të pyeturve kanë ndikim të vogël mbi formimin e vetëdijes për etnikumet e ndryshme.

### Ndjenja ndaj bashkësive të tjera etnike

Nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike tregojnë qëndrime të ndryshme në pikëpamje të marrëdhënies së tyre (pozitive dhe negative) ndaj etnikumeve tjera. Posaçërisht ndahen perceptimet e maqedonasve dhe shqiptarëve edhe në pikëpamje të ndjenjave pozitive dhe negative ndaj njëri tjetrit.

## Ndjenja pozitive

Në përgjithsi, maqedonasit në numër më të madh shprehin ndjenja pozitive ndaj serbëve (40%) dhe turqive (26.9%), ndërsa diçka numër më i vogël ndaj romëve (17.3%) dhe shqiptarëve (13.1%).

Më tepër se gjysma e shqiptarëve janë deklaruar se kanë ndjenja pozitive ndaj turqive (58%) një e treta ndaj maqedonasve (33%), pas së cilëve pasojnë romët (10.4%) dhe boshnjakët (8.9%).

Numri më i madh i turqive janë shprehur pozitivisht ndaj maqedonasve (56.5%) dhe shqiptarëve (50.3%). (shiko Grafikon 4 dhe tabela 3 në artikullin 4)

**Udhëzim për leximin e grafikonit:** Nga ana e djathtë e grafikonit me tre ngjyra të ndryshme janë paraqitur tre grupet etnike (maqedonas,


shqiptarë dhe turq) qëndrimet e të cilëve ndaj grupeve tjera vlerësohen.

Grupet etnike të cilat janë të paraqitura me bosht horizontal janë ato ndaj të cilave janë shprehur ndjenja pozitive.

Shtyllat e caktojnë përqindjen e të pyeturve maqedonas, shqiptarë dhe turq të cilët janë shprehur se kanë ndjenja pozitive ndaj çdo prej grupeve etnike të paraqitura në boshtin horizontal.

Të dhënat tregojnë se qëndrimet ndaj etnive tjera janë pjesërisht të caktuara nga përkatësia fetare (p.sh. maqedonas-serb; shqiptarë-turq e të ngjashme), e cila është e lidhur me afërsinë në traditat dhe zakonet. Megjithatë, kjo nuk është regull, dhe mund të vërehet se nxënësit turq kanë qëndrim mjaft pozitiv edhe për maqedonasit edhe për shqiptarët.

**Grafikon 4: Ndjenja pozitive për grupet tjera etnike**



Ajo që është karakteristike është mospasja e reciprocitetit në pikëpamje të ndjenjave pozitive ndaj bashkësive tjera. Derisa një e treta e shqiptarëve kanë shprehur ndjenja pozitive ndaj maqedonasve, vetëm 13% e të dytëve i kanë ndarë ndjenjat e njëjta ndaj shqiptarëve. Gjithashtu, dy herë më pak maqedonas kanë shprehur ndjenja pozitive ndaj turqive se sa kundërt. Është i dukshëm përfundimi se sa është më i madh/numërt grupi etnik, aq më pak anëtarët e tij shprehin ndjenja pozitive ndaj bashkësive tjera. Ata mesiguri perceptohen si të mjaftë për vetën e vete dhe nuk ndjejnë nevojë për, aleatë.

## Zhvillim të ndjenjave pozitive

Edhe pse numri më i madh i të pyeturve janë përgjigjur se janë bërë të vetëdijshëm për grupet tjera etnike në moshë mes 6 dhe 14 vjeçare, rreth gjysma pohojnë se kanë zhvilluar ndjenja pozitive pas moshës 10 vjeçare, ndërsa rreth 20% pas moshës 14 vjeçare (shiko tabela 4 në artikullin 4). Do të thotë, ndjenjat pozitive mesiguri nuk zhvillohen njëkohësisht me vetëdijen për etnikumet, por në moshë më të madhe. Kjo e dhënë është posaqërisht i rëndësishëm në pikëpamje të mundësisë për ndërmarrjen e aktiviteteve për zhvillimin e ndjenjave pozitive ndaj bashkësive tjera në moshë më të vogël.

Megjithatë, ekziston dallim i rëndësishëm mes maqedonasve dhe turqive, me atë që të dytit në numër më të madh janë deklaruar se i kanë zhvilluar ndjenjat pozitive në moshë 6-9 vjeçare, derisa numër më i madh nga të parët kanë deklaruar se ajo ka nodhur pas moshës 14 vjeçare.

Kjo gjendje është e kuptueshme duke e pasur parasysh se numri më i madh nga nxënësit turq jetojnë në mjediset e përziera etnike në krahasim me maqedonasit, çka nënkupton se ata janë takuar me konceptin e grupeve të ndryshme etnike më herët në jetë, dhe si pasojë kanë formuar marrëdhënie ndaj etnikumeve të caktuara.

## Dallime rajonale

Analiza e të dhënave sipas qyteteve në të cilat gjendet shkolla tregoi në variacione të mëdha rajonale në pikëpamje të ndjenjave pozitive të

shprehura, posaqërisht mes maqedonasve dhe turqive.

Në qytetet etnikisht të përziera ku nxënësit nga këta dy etnikume mësojnë bashkarisht (Shkup, Kumanovë, Strugë dhe Tetovë), ndjenjat pozitive mes dy bashkësive janë në nivel mjaft të ulur. Megjithatë, numër domethënës i madh nga shqiptarët shprehin ndjenja pozitive ndaj maqedonasve (rreth 30%), për dallim nga maqedonasit të cilët në numër më të vogël shprehin ndjenja pozitive ndaj shqiptarëve (prej 2.6% në strugë deri 14.7% në Shkup).

Gjendja me ndjenjat pozitive e maqedonasve ndaj shqiptarëve është e ngjashme edhe në qytetet ku popullata maqedonase është dominante me numër (p.sh. Manastir, Shtip, Strumicë). Në raport të perceptimeve pozitive të shprehura ndahen Dibra (me shumicë popullatë shqiptare) ku 36% nga maqedonasit janë deklaruar se kanë ndjenja pozitive ndaj shqiptarëve.

## Dallime gjinore

Përqindja e të pyeturve të cilët kanë ndjenja pozitive ndaj bashkësive tjera etnike në përgjithësi nuk dallohen sipas gjinisë. Dallimi i vetëm i regjistruar është mes nxënësve shqiptarë, ku nxënëset në numër më të madh kanë shprehur ndjenja pozitive ndaj maqedonasit (40.5%) në krahasim me bashknxënësit e tyre nga kombësia e njëjtë (25.6%).

## Ndjenja negative

Dallimet mes maqedonasve dhe shqiptarëve janë më evidente në perceptimet negative të shprehura. Nxënësit nga të dy etnikumet shprehin bindshëm ndjenja më së tepërmi negative njerit ndaj tjerëve, në krahasim me ndjenjat negative të shprehura ndaj bashkësive tjera. Më tepër se gjysma (53.7%) e nxënësve maqedonas janë shprehur se kanë ndjenja negative ndaj shqiptarëve, ndërsa më tepër se gjysma (37.6%) e shqiptarëve kanë shprehur ndjenja negative ndaj maqedonasve. Përpos ndaj shqiptarëve, maqedonasit me 15.6% kanë shprehur ndjenja negative ndaj romëve, derisa bashkësitë tjera janë të përfaqësuara me përqindje shumë të vogël. Shqiptarët nga ana tjetër, në përqindje domethënëse kanë shprehur


ndjenja negative ndaj serbëve (29%) dhe romëve (17.9%). (shiko Grafikoni 5).

Nxënësit nga kombësia turke në përqindje më të madhe janë shprehur se kanë ndjenja negative ndaj shqiptarëve (40.9%), ndërsa në numër më të vogël ndaj serbëve (19.1%), maqedonasve dhe romëve (me 10%).

Vetëm numër i vogël i të pyeturve (6.7%) janë përgjigjur se fare nuk kanë ndjenja negative ndaj etnikumet tjera. Ajo është më shpesh rast tek maqedonasit dhe turqit.

Duhet të theksohet e dhëna se mes maqedonasve dhe shqiptarëve ndjenjat negative janë larg më dominante në krahasim me ndjenjat pozitive dhe ato mesatarisht numërojnë më tepër grupe etnike ndaj të cilave kanë ndjenja negative se sa ndjenja pozitive. Kjo na habit duke e pasur parasysh atmosferën e përgjithshme shoqërore në të cilën vazhdimisht theksohen dallimet

**Grafikon 5: Ndjenja negative për grupet tjera etnike**



mes bashkësive etnike (posaqërisht mes maqedonasve dhe shqiptarëve) në pikëpamje të qëstjeve të ndryshme shoqërore, njëkohësisht duke i menjuar aspektet të cilat i bashkojnë të dy grupet.

Udhëzimet për leximin e grafikoni janë të njëjta si në të mëparshmin (Grafikoni 4)

## Zhvillim i ndjenjave negative

Gati gjysma e të pyeturve janë pëtgjigjur se ndjenjat negative kanë filluar ti zhvillojnë pas moshës 10 vjeçare (27% deri 10-14 vjet dhe 21% pas 14 vjet). Pjesa më e madhe nga kjo përqindje u përkasin nxënësve maqedonas dhe shqiptarë, derisa gati gjysma nga nxënësit turq nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. (shiko tabela 6 në artikullin 4). Edhe për zhvillimin e ndjenjave negative vlen e njëjta rregull si te ndjenjat pozitive, gjegjësisht zhvillohen pas përfitimit të vetëdijes për ekzistimin e grupeve të ndryshme etnike.

## Dallime rajonale

Dallimet rajonale në pikëpamje të ndjenjave të shprehura negative mes nxënësve maqedonas dhe shqiptarë janë ende më të mëdha nga ato të vërejtura në rastin e ndjenjave pozitive. Ndjenjat e ndërsjella negative të të dy bashkësive janë më të avancuara në Strugë ku 98% nga maqedonasit dhe 96% nga shqiptarët kanë shprehur se kanë ndjenja negative ndaj bashkësisë tjetër etnike. Në qytetet tjera të përzier etnikisht, ndjenjat negative mes dy bashkësive janë gjithashtu të tejkaluara nga ndjenjat pozitive dhe në numër rendësishëm të madh janë shprehur nga ana e maqedonsve ndaj shqiptarëve (53.7% në Shkup, 82.4% në Tetovë dhe 73.3% në Kumanovë), se sa nga ana e shqiptarëve ndaj maqedonasve (37.6% në Shkup, 53.3% në Tetovë dhe 28.4% në Kumanovë).

Në qytetet ku popullata maqedonase është dominante me numër, më pak se gjysma e nxënësve maqedonas kanë shprehur ndjenja negative ndaj shqiptarëve (38% në Manastir, 37% në Strumicë, 47% në Shtip dhe 48.5% në Veles).

Shumë është e mundshme se në qytetet e përziera etnike popullata maqedonase në masë të madhe e percepton popullatën shqiptare si kërcnim (për identitetin, teritorin, traditën dhe të ngjashme) dhe si konsekuencë më shpesh zhvillon perceptime negative ndaj të njëjtës. Nga ana tjetër, në qytetet e „pastra, etnike tensionet e këtilla nuk ndjehen në mënyrë direkte, çka i zvogëlon perceptimet negative.

## Dallime gjinore

Në pikëpamje të perceptimeve negative, vërehen dallime mbi bazën e gjinisë të të pyeturve te të dy grupet më të mëdha etnike. Pjesa më e madhe e djemve maqedonas, në krahasim me vajzat kanë deklaruar se kanë ndjenja negative ndaj shqiptarëve (68.3% përkundër 58.7%). Njëkohësisht, pjesa më e madhe e vajzave janë deklaruar se nuk kanë ndjenja negative ndaj as një grupi etnik (15.5% përkundër 8.5%).

Pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë kanë shprehur ndjenja negative ndaj maqedonsve në krahasim me bashknxënësit e tyre nga

kombësia e njejtë (51.7% përkundër 43.8%). Nga ana tjetër nxënëset shqiptare në numër më të madh kanë ndjenja negative ndaj romëve në krahasim me bashknxënësit e tyre shqiptarë (28% përkundër 18.6%).

Dukshëm ndjenjat negative mes dy grupeve më të mëdha etnike (maqedonasit dhe shqiptarët), edhe pse mjaft të shprehura mes nxënësve, janë më të përfaqësuara te nxënësit meshkuj. Kjo është e pritur duke e pasur parasysh se marrëdhëniet direkte jomiqësore (p.sh. rrahjet, zënkat verbale e të ngjashme) më së tepërmi manifestohen nga ana e djemve.

## Shpeshësia e kontaktit me bashkësitë e tjera etnike

Në pikëpamje të frekuencës së kontaktit me grupet e ndryshme etnike në kornizat e shkollës, më të shpeshta janë kontaktet me maqedonasit, me të cilët 41.5% e nxënësve nga prejardhja etnike jomaqedonase kanë kontakte të shpeshta, çka është e kuptueshme duke e pasur parasysh se janë popullatë shumicë. Numër i konsiderueshëm i të pyeturve nga prejardhja shqiptare (40%) fare nuk kanë kontakte me shqiptarë në shkollë, derisa 33.7% kanë kontakte të rralla. (shiko tabela 7 në artikull 4).

Rezultatet tregojnë se nxënësit nga kombësia maqedonase janë më të izoluarit në kornizat e grupit të tyre etnik. Thuajse gjysma (46%) fare nuk kanë kontakt me shqiptarët, ndërsa rreth 40% nuk kontaktojnë me turq dhe romë. Vetëm rreth 20% prej tyre kanë deklaruar se kanë kontakte të shpeshta me turqit dhe serbët, ndërsa rreth 15% me shqiptarët dhe romët.

Nxënësit shqiptarë në numër më të madh janë deklaruar se kanë kontakt të shpeshtë me maqedonasit (40%), ndërsa dyfish më pak me turqit (20%). Numër më i madh i tyre (mbi 60%) fare nuk kanë pasur kontakt me romë në shkollë.

Turqit, sipas deklaratave të tyre më së tepërmi janë në kontakt me grupet e tjera etnike. Pjesa më e madhe prej tyre (66.3%) kanë deklaruar se kanë kontakte të shpeshta me maqedonasit, 48% me shqiptarët, ndërsa 20.7% me romët.



Më së tepërmi kontakt me serbët kanë maqedonasit, derisa shqiptarët dhe turqit shumë rrallë (81% nga të parët dhe 68% nga të dytë fare nuk kanë kontakt).

**Nuk ekzistojnë dallime gjinore** në pikëpamje të shpeshtisë së kontaktit me bashkësitë e ndryshme etnike.

## Shpeshtia e kontaktit dhe ndjenja ndaj bashkësive të tjera etnike

Është për tu pritur shpeshtia e kontaktit të jetë i lidhur me qëndrimin ndaj bashkësitë të caktuar etnike. Hulumtimi tergoi se lidhmëri e këtyre ekziston, edhe pse relacioni i lidhjes nuk mundet të vërtetohet (gjegjësisht vallë frekuenca e kontaktit ndikon në ndjenjat ose ndjenjat e përcaktojnë frekuencën e kontaktit).

Ajo që është me rëndësi është se në rastin e **nxënësve maqedonas**, kontaktet më të shpeshta me turqit, shqiptarët dhe romët janë të lidhur me ekzistimin e ndjenjave pozitive ndaj këtyre bashkësive, derisa kontaktet e ralla ose mospasja e kontaktit është e lidhur me ekzistimin e ndjenjave negative ndaj bashkësisë së njejtë. Identik është rasti me **nxënësit shqiptarë** ku përqindja më e madhe nga ata të cilët kanë kontakte të shpeshta kanë shprehur ndjenja pozitive ndaj maqedonasve dhe romëve, derisa numri më i madh nga ata të cilët nuk kanë kontakte – negative.

Mund të paramendohet se këto kontakte nuk kanë domethënie vetëm bashkë koegzistuese në mjedis të caktuar, për shkak se ajo nga vetë vetja nuk siguron kontakt të domosdoshëm, por nënkupton interakcion më aktiv mes bashkësive.

## Dallime rajonale në shpeshtinë e kontaktit

Interesante, në disa qytete ku shumica e madhe e popullatës është maqedonase, por ekziston edhe numër të vogël të popullatës shqiptare (p.sh. Manasatir, Resnjë, Demir Hisar), nxënësit maqedonas janë deklaruar se kanë kontakte më të shpeshta me shqiptarët se sa në qytetet ku popullata është e përzier (p.sh. Gostivar, Tetovë, Kërçovë). Kjo mesiguri është si rezultat i domosdoshmërisë nga interaksioni më i madh

i nxënësve shqiptarë me maqedonasit në bashkësitë ku të dytë dominojnë për nga numri dhe ku, mbyllja, e shqiptarëve në kornizat e grupit të tyre është vështirë.

Në numër të madh në qytetet e përzier etnikisht (p.sh. tetovë, Gostivar, Kërçovë, Kumanovë), përqindje e madhe e nxënësve maqedonas kanë deklaruar se fare nuk kanë kontakt me shqiptarët (50.6% në Kumanovë deri 33.6% në Tetovë). Mund të konstatohet se afërsia fizike e bashkësive etnike nuk është garancë për interaksionin e tyre, por përkundrazi nëse ekzistojnë tenziona, ekziston kërcnimi ai të shpiet në minimum.

I ngjashëm është rasti edhe me nxënësit shqiptarë, të cilët në përqindje më të madhe janë deklaruar se kanë kontakt me maqedonasit në mjediset ku janë me numër më të vogël nga maqedonasit (Veles, Manastir, Resnjë, Shkup). Është e vërejtshme se numër relativisht i vogël prej tyre janë përgjigjur se fare nuk kontaktojnë me maqedonasit. Mungesa e kontaktit është më e shprehur në Strugë (20.9%), Gostivar (23.1%) dhe Kumanovë (18.4%).

# Shkolla dhe marrëdhëniet ndëretnike

Pjesa e pyetësorit e cili i përkiste sistemit arsimor, kishte për qëllim ti hulumtoj qëndrimet e nxënësve në lidhje me rolin e shkollës dhe aspektet e veçanta të tij (mësues, libra shkollore, bashknxënës) në zhvillimin dhe kualitetin e marrëdhënieve ndëretnike. Këto faktorë pastaj ishin të koreluar me perceptimet ndaj grupeve etnike, me qëllim të hulumtohet lidhmëri e mundur.

## Faktorë nga shkolla të cilët ndikojnë në formimin e qëndrimeve për bashkësitë etnike

### Mësues

Një nga faktorët më të rëndësishëm në shkollë të cilët ndikojnë në formimin e qëndrimeve janë mësuesit. Roli i tyre nuk është vetëm arsimues por edhe edukues dhe do të duhet të jetë i përcjellur me zhvillimin e vlerave pozitive morale (duke i kyqur edhe vlerat ndëretnike). Duke e pasur këtë parasysh, është interesant e dhëna se thuajse gjysma e të pyeturve (47.6%) janë deklaruar se kanë dëgjuar (shpesh ose ndonjëherë) komente ofenduese për bashkësitë etnike tjera nga ana e mësuesve (Grafikoni 6). Edhe pse relativisht numër i vogël i nxënësve


janë përgjigjur se shpesh kanë ndëgjuar komente të këtylla nga ana e mësuesve, këtë e kanë konfirmuar numër konsiderueshëm i madh i shqiptarëve në krahasim me maqedonasit dhe turqit.

Nuk ka dallim në pikëpamje të shpeshtisë e dëgjimit të komenteve negative nga ana e mësuesve mes nxënësve nga qytetet e pjesës lindore dhe perendimore të Maqedonisë, frekuenca në të dy rastet përshtatet me trendin e përgjithshëm.


Rezultatet tregojnë se ajo që mësuesit e kanë terguar ka ndikim mbi qëndrimet e rreth 40% të nxënësve, ndërsa godet numër domethanës të nxënësve nga kombësia shqiptare (44.5%) se sa maqedonase (34.1%) (Grafikoni 7). Kjo deri diku është e pritur duke e pasur parasysh të dhënën se për shqiptarët mësuesit janë faktor më i rëndësishëm i cili e definon marrëdhënien e tyre ndaj bashkësive etnike tjera në krahasim me nxënësit nga kombësitë tjera (shiko tabela 2 në artikullin 4). Komentet negative të mësuesve kanë posaqërisht ndikim nëse shprehen shpesh.

Në raste të caktuara dëgjimi i shpeshtë i komenteve negative është rëndësishëm i lidhur me pasjen e ndjenjave negative ndaj grupi të caktuar etnik. Te maqedonasit, komentet e

**Grafikon 6: Shpeshtia e komenteve negative të mësuesve ndaj grupeve tjera etnike**



**Grafikon 7: Ndikimi i komenteve negative të mësuesve mbi studentat**



shpeshta nga ana e mësuesve janë të lidhur me pasjen e ndjenjave negative ndaj shqiptarëve, por jo edhe ndaj turqive. Mes shqiptarëve nga ana tjetër, edhe pse mësuesit janë vlerësuar si mjaft të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve ndaj grupeve etnike, nuk është gjetur lidhmëri mes komenteve të tyre dhe ndjenjave negative ndaj bashkësive të tjera etnike.

### Bashknxënës

Rreth 40% e të pyeturve janë deklaruar se ndjenjë presion nga bashknxënësit nga grupi i tyre etnik të mos shoqërohen me grupet e tjera etnike. Presion të këtillë ndjejnë përqindje më të madhe nga nxënësit shqiptarë (11% - shpesh dhe 40% - disa herë),, ndërsa numër më i vogël i nxënësve maqedonas dhe turq (shiko Grafikoni 8).

Për maqedonasit presioni nga bashknxënësit është i lidhur me pasjen e ndjenjave negative ndaj shqiptarëve, por jo edhe ndaj grupeve tjera etnike. Gjithashtu, te shqiptarët presioni


i moshatarëve është i lidhur me posedimin e ndjenjave negative vetëm ndaj maqedonasve. Edhe pse në pyetjen nuk ishte i theksuar grupi etnik për të cilin bëhet presion, mesiguri te maqedonasit ajo janë shqiptarët dhe anasjelltas.

Megjithate, edhe te të dy bashkësitë më të mëdha etnike presioni nga ana e bashknxënësve nuk është i lidhur me shpeshinë e kontaktit me grupet tjera etnike. Mjaft është e sigurtë se kontakti për të cilin flasin më së shpeshti nuk është miqësor, por interaksion i thjeshtë i cili lajmërohet si rezultat i koegzistimit të përbashkët në një mjedis.


### Libra shkollor

Edhe pse numër relativisht i vogël i të pyeturve i treguan librat si faktor i cili ndikon në formimin e vetëdijes për bashkësitë e ndryshme etnike, ata megjithate vlerësohen si faktor i cili mundet të ndikoj në qëndrimet ndaj bashkësive tjera, mbi çka posaqërisht ndikon mënyra më të cilën

**Grafikon 8: Ndjenjat e studentave nga ndikimi i presionit nga moshatarët**



**Grafikon 9: Pikëpamjet e studentave se si grupi etnik i tyre është i paraqitur në librat shkollorë**




ata janë të paraqitur në librat shkollorë. Në këtë pikëpamje gjendja mes maqedonasve dhe bashkësive tjera të mëdha joshumicë dallohen konsiderueshëm. Derisa të parët në numër më të madh (80%) vlerësojnë se grupi i tyre etnik është në mënyrë të përshtatshme i paraqitur, më tepër se 40% nga të tjerët vlerësojnë se janë të paraqitur në mënyrë jo të përshtatshme (Grafikoni 9). Ajo që brengos është se rreth një e treta e të pyeturve vlerësojnë se grupi i tyre etnik nuk është i paraqitur në mënyrë të përshtatshme në librat shkollorë.

Nxënësit theksojnë tre faktorë të cilët sipas tyre më së tepërmi ndikojnë në shkaktimin e armiqësisë (zënka, rrahje) mes nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike: paragjykimet e nxënësve (43%), ndikimi i partive politike (43.8%) dhe dallimet kulturore (44.2%).

Megjithate, nxënësit e etnikumeve të ndryshme nuk u japin prioritet faktorëve të njejtë. Derisa për numër konsiderueshëm më të madh nga shqiptarët në krahasim me maqedonasit, më të rëndësishëm janë mësuesit, dallimet kulturore dhe mënyra e udhëheqjes së shkollave e cila favorizon një grup etnik; pjesa më e madhe e maqedonasve paragjykimet e nxënësve i vlerësojnë për një nga faktorët kryesorë. (shiko Grafikoni 10, Tabela 11 në artikullin 4)

### Shkaqe për armiqësi mes nxënësve nga përkatësia e ndryshme etnike në shkollat

**Grafikon 10: Pikëpamjet e nxënësve për shkaqet e armiqësisë në shkollat**




## Roli i shkollës në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike

Nxënësit dukshëm detektojnë numër të madh të shkaqeve për marrëdhëniet e tendosura në shkollë, një pjesë të cilave në mënyrë direkte janë të lidhura me shkollën. Për shkak të kësaj, ishin të pyetur ta vlerësojnë rolin e shkollës së tyre në zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndëretnike.

Shumica (gadi 70%) u përgjigjën se në kornizat e shkollës së tyre janë ndërmarrë masa (aktive – 30% ose më pak aktive – 38%) për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike (Grafikoni 11).

Ky qëndrim është më prezent mes nxënësve nga përkatësia turke, mesiguri për shkak se ata më së shpeshti mësojnë në mjedise të përziera etnike, ku marrëdhëniet e këtilla janë më të shpeshta. Mëtuftje, shqiptarët në numër më të madh vlerësojnë se shkolla ndërmerr masa aktive në krahasim me maqedonasit, të cilët

**Grafikon 11: Promovimi i marrëdhënieve ndëretnike nga shkollat**



kryesisht janë deklaruar se ndërmerren masa të caktuara.

Masat të cilat i ndërmerr shkolla nuk janë të mjaftueshme nga vetja, pa promovimin e nxënësve të marrin pjesë në aktivitete me nxënësit nga kombësitë tjera. Përgjigjet e tyre tergojnë se te shumica e madhe e nxënësve (80%) ekziston gadishmëri të marrin pjesë në aktivitete me nxënësit nga kombësitë tjera.

Shqiptarët në përqindje më të madhe tregojnë gadishmëri të marrin pjesë në aktivitete të këtilla, derisa turqit në përqindje më të vogël. (shiko Grafikoni 12, Tabela 13 në artikullin 4)

Jogadishmëria nga ana tjetër për të marrë pjesë në aktivitete të këtilla mes maqedonasve është e lidhur me pasjen e ndjenjave negative ndaj shqiptarëve, turqive, ndërsa në shkallë më të vogël edhe ndaj romëve. Ndërsa te shqiptarët është e lidhur me pasjen e ndjenjave negative ndaj maqedonasve dhe romëve. Edhe pse aktivitetet e këtilla kanë për qëllim ti zvogëlojnë paragjykimet ndaj bashkësisë tjera, ekziston reziku që ata nxënës të cilët perceptimet negative janë më të dukshme që fare mos të kyqen në ato.


Nxënëset nga kombësia maqedonase dhe shqiptare janë më tepër të prirura ndaj pjesëmarrjes në aktivitete të këtilla në krahasim me bashknxënësit e tyre nga kombësia e njejtë; ndërsa mes turqive nuk ekzistojnë dallime gjinore në pikëpamje të gadishmërisë për pjesëmarrje.

Motivimi për pjesëmarrje në aktivitete ndëretnike gjithashtu është e lidhur me shkaqet të cilat nxënësit i vlerësojnë për më me ndikim për tensionet ndëretnike. Prej atyre të cilët vlerësojnë se dallimet kulturore janë faktor dominant, numri më i madh nuk do të kishin marrë pjesë në aktivitete të këtilla, derisa numër më i madh prej atyre të cilët vlerësojnë se ato janë paragjykimet, do të kishin marrë pjesë. Mesiguri dallimet kulturore perceptohen si diçka që është vështirë të

tejkalohej, derisa paragjykimet si diçka lehtë e tejkaloeshme, edhe ate posaqërisht përmes kontakteve me të tjerët. Trendi i njejtë paraqitet edhe te shqiptarët edhe te maqedonasit.

E dhënë shtesë është se shumica e të pyeturve (61.1%) kanë shprehur **pajtueshmëri me deklaratën se, Shkollat me përbërje të përziera etnike kontribuojnë ndaj përmirësimit të marrëdhënieve mes grupeve etnike në**


**Grafikon 12: Gadishmëria e studentave për pjesëmarrje në aktivitete me grupe të tjera etnike**



**vend.** Megjithate, qëndrimet e të pyeturve nga bashkësitë e ndryshme etnike konsiderueshëm dallohen edhe në pikëpamje të kësaj pyetjeje. Nga Grafikoni 13 mund të shifet se nxënësit turq në numër më të madh kanë shprehur pajtueshmëri me këtë deklaratë (77.5%) derisa nxënësit shqiptarë në diçka numër më të vogël janë pajtuar (68%), ndërsa maqedonasit në numër më të vogël janë pajtuar me deklaratën (57%).

(Mos) pajtueshmëria me deklaratën është e lidhur me qëndrimet ndaj grupeve të caktuara etnike. Për shembull, maqedonasit të cilët kanë ndjenja negative ndaj shqiptarëve dhe turqive në numër më të madh kanë shprehur mospajtueshmëri me idenë për përbërje të përziera etnike në shkollat në krahasim me ata të cilët nuk janë deklaruar se nuk kanë ndjenja negative ndaj keto bashkësi etnike. Gjithashtu, shqiptarët, të cilët kanë më tepër ndjenja pozitive se sa negative ndaj maqedonasve është më e sigurtë se do të pasjtohen me idenë për multietnicitet në arsim. Do to thotë ata të cilët veç më kanë të ndërtuar ndjenja pozitive ndaj bashkësisë të caktuar ose nuk kanë ndërtuar ndjenja negative janë më tepër të prirur ta pranojnë konceptin e

**Grafikon 13: Pikëpamjet e studentave për ndikimin e shkollave etnikisht të përziera ndaj marrëdhënieve ndëretnike**



shkollave multietnike. Mund të përfundohej se marrëdhënia primare (pozitiv ose negativ) ndaj bashkësisë tjetër është vendimtarë për ndërtimin e qëndrimeve të mëtutjeshme ndaj multietnicitetit në arsim.

Pajtueshmëria me idenë për efektet pozitive të multietnicitetit në arsim është e lidhur me thujtje të gjitha indikatorët shkollorë të cilët ishin të hulumtuar: degjuar më e rrallë e komenteve negative për bashkësitë tjera nga ana e mësuesve te maqedonasit; ndikim më të vogël të komenteve negative të mësuesve te maqedonasit; mungesa e presionit nga ana e bashknxënësve që të mos shoqërohen me nxënësit nga grupet tjera etnike; gadishmëri për pjesëmarrje në aktivitete në shkollë me nxënësit nga etnikumet tjera; si dhe kontakte më të shpeshta me bashknxënësit nga kombësitë tjera.

E dhëna tregon se faktorët e prezentuar mesiguri janë në interaksion të ndërsjellë dhe qëndrimet e mësuesve dhe bashknxënësve kanë ndikim mbi zhvillimin e tolerancës për mirëqenie nga shkollat me përbërje të përziera etnike, posaqërisht në rastin e nxënësve maqedonas.

## Studim i rastit – Strugë

Qyteti i Strugës ishte i zgjedhur si studim i rastit duke i marrë parasysh të dhënat të fituara për nivelin e lartë të ndjenjave armiqësore mes nxënësve të dy bashkësive më të përfshira etnike – maqedonas dhe shqiptarë. Qëllimi është të jepet pasqyrë e indikatorëve meqëllim të vërtetohet cilat do të ishin arsyet e mundshme për nivelin e lartë të tenzioneve mes nxënësve të të dy bashkësive.

Siç u tha më lartë, në Strugë, thuajse të gjithë pjesëtarët e grupit të njejtë etnik të cilët janë përgjigjur në pyetjen ndaj të cilave etnikumeve kanë **ndjenja negative** kanë dhënë përgjigje të njëzëshme, gjegjësisht bindshëm pjesë më të madhe nga maqedonasit kanë shprehur perceptime negative ndaj shqiptarëve dhe anasjelltas. Megjithate, me rëndësi është të theksohet se diçka më tepër se gjysma e nxënësve (edhe nga të dy etnikumet) fare nuk i janë përgjigjur pyetjes. Kjo është e dhënë interesante dhe mund të ketë domethanien se ato frigohen ta shprehin mendimin e tyre duke i pasur parasysh tenzionet etnike të cilat ndodhnin në qytetin gjatë vitit të kaluar shkollor (2008/09).

Edhe pse jetojnë dhe mësojnë në mjedis të përzier etnik, nxënësit maqedonas dhe shqiptarë relativisht rallë kanë **kontakt të ndërsjellë**. Vetëm rreth një e treta (30.8% e maqedonasve dhe 34.9% e shqiptarëve) janë deklaruar se kanë kontakte të shpeshta të ndërsjella, derisa numri më i madh kanë kontakte të ralla ose fare nuk kontaktojnë. Edhe kontaktet me grupet etnike tjera janë të rralla (posaqërisht me romët), çka tregon se nxënësit janë mjaft të mbyllur në kornizat e grupit etnik të tyre dhe kontaktet e ndërsjella mesiguri lajmërohen si rezultat i nevojës së jashtme (p.sh. ngjarje në kornizat e shkollës), ndërsa më pak me iniciativë individuale.

Numri më i madh i nxënësve nga të dy grupet etnike (88% maqedonas dhe 74% shqiptarë) **shkakun për armiqësitë në shkollën** e shikojnë në ndikimin e partive politike. Megjithate, konsiderueshëm më tepër shqiptarë se sa maqedonas (63% përkundër 21.7%) vlerësojnë se një nga arsyet kryesore janë dallimet kulturore mes etnikumeve. Dy faktorët më të rëndësishëm janë të ndryshëm sipas natyrës së tyre, me ate që i pari është i jashtëm

dhe jashtë ndikimit/kontrollit të nxënësve, ndërsa i dyti i brendshëm, mirëpo i komplikuar për tejkalim.

Tjetër e dhënë frapante është niveli i **pranueshmërisë së qëndrimit se përbërja e ndryshme etnike e shkollave kontribon për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike**. Derisa numri më i madh i nxënësve shqiptarë (73%) pajtohen me këtë qëndrim, më pak se një e treta (28.6%) e maqedonasve e ndajnë këtë mendim. Edhe krahas kësaj, shumica (82% maqedonas dhe 80% shqiptarë) kanë deklaruar se do të kishin marrë pjesë në aktivitete me bashknxënësit nga kombësitë tjera. Megjithate, edhe krahas motivimit të tyre për pjesëmarrje në aktivitetet multietnike, nxënësit në numër më të madh (43.6%) vlerësojnë se shkolla nuk merr masa për avancimin e marrëdhënieve të mira ndëretnike, qëndrim i cili është posaqërisht i përfaqësuar te maqedonasit. Kjo përqindje është konsiderueshëm e madhe në krahasim me pjesën tjetër të shembullit, edhe pse bëhet fjalë për qytet në të cilin tenzionet ndëretnike ishin më të shprehura në periudhën e kaluar.

E dhënë me rëndësi është se rreth gjysma e nxënësve nga të dy etnikumet kanë deklaruar se kanë ndëgjuar **koment ofendues nga ana mësuesve** të drejtuara ndaj grupeve të tjera etnike. Megjithate, perceptimi në lidhje me këta komente mbi formimin e qëndrimit individual për grupet tjera etnike është i ndryshëm gjegjësisht pjesa më e madhe e shqiptarëve në krahasim me qëndrimin e tyre personal. I ngjashëm është edhe rasti me **presionin nga ana e bashknxënësve** të mos shoqërohen me nxënësit nga grupet tjera etnike, i cili është më i përfaqësuar te nxënësit shqiptarë.

Në përgjithësi, qëndrimet e nxënësve nga Struga dallohen në shumicën e aspekteve nga pjesa tjetër e shembullit. Ata kanë deklaruar se më shpesh dëgjojnë komente ofenduese nga ana e mësuesve, më shpesh kanë presion nga nxënësit për mosshoqërim me moshatarët nga etnikumet tjera, në dukshëm shkallë më të lartë i vlerësojnë partitë politike dhe mënyrën e udhëheqjes me shkollat për faktorë kyq për tenzionet etnike dhe në përqindje më të vogël në krahasim me pjesën tjetër të shembullit vlerësojnë se shkollat ndërmarrin masa për ballafaqim me tenzionet. Këto të dhëna tregojnë në mundësinë se pjesë e rëndësishme e perceptimeve negative janë të shkaktuara

nga faktorë negativ të cilët mund sistematikisht të ndryshohen, mirëpo mbi të cilët vet nxënësit kanë shumë ndikim të vogël.

## Përrundim

Vetëdija për ekzistimin e grupeve tjera etnike, sipas vlerësimit të nxënësve është lajmëruar në periudhën nga mosha 6-14 vjeçare, derisa qëndrimet për bashkësi të caktuara te pjesa më e madhe janë zhvilluar në vonë pas moshës 10 vjeçare. E pritur, si faktor më me ndikim për formimin e vetëdijes nga ana e të gjithë nxënësve janë të përmendur prindët, po si të radhës me rëndësi janë të përmendur mediat (posaqërisht maqedonasit) dhe shokët (posaqërisht turqit).

Mes nxënësve maqedonas dhe shqiptarë ndjenjat negative dominojnë mbi pozitive. Karakteristike është që perceptimet negative janë më të shprehura në qytetet e përziera etnike (posaqërisht Struga) dhe më shpesh të shprehur nga ana e djemve nga të dyja bashkësitë etnike.

Rezultatet tregojnë se kontaktet më të shpeshta me bashkësitë tjera etnike janë të lidhura me pasjen e perceptimeve pozitive ndaj të njejtave. Megjithate, marrë në përgjithësi, sa është më i numërt grupi etnik, aq është më i mbyllur në kornizat e grupit të vet. Dhe kështu, nxënësit e kombësisë maqedonase kanë më së paku kontakte jashtë grupit të vet etnik, derisa turqit kanë më së tepërmi kontakte me nxënësit nga etnikumet tjera. Ajo që duhet të vërtetohet plotësisht është kahja e lidhmërisë, gjegjësisht vallë kontaktet ndikojnë në kuptimin e ndjenjave pozitive ose ndjenjat pozitive shpiejnë kah kontaktet më të shpeshta. Megjithate, jetesa në mjedis multietnik nuk nënkupton patjetër dhe kontakte të shpeshta. Në gjenjde të tenzioneve të larta ndëretnike, interaksioni ndëretnik në këta mjedise shpeshherë shpjet në minimum. Faktorët shkollorë (mësuesit, bashknxënësit, librat shkollorë, aktivitetet shkollore dhe të ngjashme) janë mjaft të përziera me indikatorët tjerë dhe kanë ndikim të konsiderueshëm mbi qëndrimet e nxënësve ndaj multietnicitetit dhe perceptimit të grupeve të tjera etnike. Gadi gjysma e nxënësve kanë deklaruar se kanë dëgjuar

komente ofenduese nga ana e mësuesve ndaj grupeve të tjera etnike, ndërsa rreth një e treta kanë ndjerë presion nga ana e bashknxënësve të mos shoqërohen me nxënësit e etnikumeve tjera. Këta faktorë i ndjejnë numri më i madh i nxënësve shqiptarë në krahasim me grupet e tjera etnike. Megjithate, shkaqet kryesore për tenzionet etnike, sipas nxënësve nuk janë direkt të lidhura me shkollën. Ata janë: paragjykimet e nxënësve, ndikimi i partive politike dhe dallimet kulturore.

Edhe krahas tenzioneve të larta ndëretnike të cilat i panë nxënësit, mund të vërehet se, numri më i madh i tyre (prej të cilëve shumica shqiptarë dhe turq se sa maqedonas) janë me qëndrimin se shkollat multietnike kontribojnë për përmirësimin e marrëdhënieve mes etnikumeve dhe te shumica e madhe prej tyre (70%) ekziston motivimi për pjesëmarrje në aktivitete me nxënës nga kombësi tjera.

Mund të përfundohet se edhe pse paragjykimet janë të larta, nxënësit janë të vetëdijshëm për këtë dhe janë të aftë që në mënyrë të saktë ti identifikojnë shkaktarët e gjendjes së këtyllë. Duke i pasur parasysh të dhënat se kontakti më i shpeshtë shkon bashkarisht me perceptimet pozitive ndaj bashkësive të tjera etnike dhe gadishmëria e përgjithshme e nxënësve për interaksion me nxënësit e etnikumeve tjera, aktivitetet shkollore të drejtuara ndaj interaksion më të shpeshtë nuk janë vetëm të mirëseardhura, por edhe të nevojshme për çarjen e paragjykimeve negative dhe tejkalimin e dallimeve kulturore.

# Rekomandime për aktivitetet dhe hulumtimet e ardhëshme

Derisa qëllimi i këtij studimi ishte të realizoj mirëkuptim më të mirë për perceptimet gjërisht të shpërndara mes gjimnazistëve, rezultatet e tij paraqesin bazë për numër të madh të rekomandimeve. Njëkohësisht, u bë evidente se ekziston nevoja prej hulumtimeve të mëtutjeshme dhe kuptim më të thellë të shumë aspekteve të cilat ishin të prekur nga ky studim.

Duke e pas paraysh moshën e hershme, kur zhvillohet vetëdija për laramaninë etnike, e rëndësishë së madhe është roli i shkollave në kultivimin e ndjenjave pozitive dhe mirëkuptim mes bashkësive etnike të ndryshme. Si plotësim i aktiviteteve të zhvilluara në bashkëpunim me shkollat, është e domosdoshme kyqja e familjeve, miqve dhe mediave, sepse të pyeturit i identifikojnë si faktor më të rëndësishëm në krijimin e vetëdijes për dallimet etnike.

Gjatë planifikimit të aktiviteteve, duhet marrë parasysh faktorët të cilët grupet e ndryshme etnike i vlerësojnë si shkaqe më të rëndësishme për mostolerancën. Derisa shumica e maqedonasve etnik mendojnë se pasqyra e gabuar dhe paragjykimet ndaj bashkësive tjera etnike luajnë rol kryesor, pjesa më e madhe e shqiptarëve etnik e theksojnë rëndësinë e mësuesve, dallimet kulturore dhe menaxhmentin shkollor në favor të grupit të caktuar etnik. Sipas kësaj, aktivitetet duhet të kaplojnë disa aspekte të ndryshmeve – prej punës së paragjykimeve dhe pranimin e dallimeve kulturore deri te ndryshimet sistematike në menaxhimin me shkollat multietnike.

Aktivitetet jashtëshkollore nuk duhet të fokusohen vetëm mbi nxënësit e interesuar. Derisa aktivitetet multietnike në shkollat kanë për qëllim zvogëlimin e paragjykimeve ndaj bashkësive të tjera, ekziston reziku nxënësit të cilët më së tepërmi kanë zhvilluar perceptime negative mos të marrin pjesë në ato. Për këtë

kyqja e këtyre nxënësve në këto aktivitete multietnike duhet të shkoj duar ndër duar me masat tjera indirekte për „zbutjen“, e qëndrimeve (për shembull, promovimi i vlerave të përbashkëta përmes mediave, mësimit, menaxhmentit shkollorë).

Derisa hulumtimi i tanishëm siguron kuptim më të mirë të aspekteve të shumta, ai, poashtu, i thekson edhe çështjet të cilat kërkojnë hulumtim plotësues. Me qëllim që të fitohet pasqyrë më e mirë e disa nga rezultatet, do të jetë i dobishëm hulumtimi i mëtutjeshëm për llojin e kontaktit mes nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike, me qëllim që të caktohet se vallë ato janë sipërfaqësore ose, kontakte më të thella dhe të rëndësishme. Poashtu, do të jetë e nevojshme të fitohet kuptim thelbësor i llojeve negative të komenteve të cilat i japin mësuesit dhe si ato pranojnë nga nxënësit. Mëtutjue, prioritet tu jepjen edhe masave të cilat shkollat vazhdimisht i ndërmarrin për zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndëretnike dhe si studentët shikojnë ndaj masave të dhëna. Poashtu, ekziston nevoja të caktohet vallë mendimi i disa studentëve, se bashkësia e tyre etnike nuk është paraqitur objektivisht në materialet mësimore është e bazuar në supozime të përgjithshme ose, shembuj konkret. Të nevojshme janë analiza më të thella që të zbulohet mënyra në të cilën paraqitet e bashkësive etnike në librat shkollorë mund ta formojnë në perceptime grupore dhe qëndrime.

## Artikuj

### ARTIKULLI 1 - PYETËSOR

ARSIMI DHE MARRËDHËNIET NDËRETNIKE

PYETËSOR PËR SHKOLLA TË MESME

1. Në cilën moshë u bëne i/e vetëdëshëm/me për jetesën e grupeve të ndryshme etnike në vend?
  - a) Në moshë 2-5 vjeçare
  - b) Në moshë prej 6-9 vjeçare
  - c) Në moshë prej 10-14 vjeçare
  - d) Pas moshës 14 vjeçare
2. Kush ose çka kontriboi të bëhesh i/e vetëdëshëm/me se në vend jetojnë pjesëtarë të grupeve të tjera etnike?
  - a) Shokë
  - b) prindë
  - c) mësues
  - ç) gazeta, radio, TV & internet
  - d) libra
  - dh) bashknxënës
  - e) \_\_\_\_\_
3. Shkruaje emrin e gripit/eve etnik/e për të cilën ke ndjenja pozitive:  
\_\_\_\_\_
4. Kur fillove ti zhvillosh këto ndjenja pozitive?
  - a) Në moshë prej 2-5 vjeçare
  - b) Në moshë prej 6-9 vjeçare
  - c) Në moshë prej 10-14 vjeçare
  - ç) Pas moshës 14 vjeçare
5. Shkruaje emrin e grupit/eve për të cilat/ën ke ndjenja negative:  
\_\_\_\_\_
6. Kur fillove ti zhvillosh këto ndjenja negative?
  - a) Në moshë prej 2-5 vjeçare
  - b) Në moshë prej 6-9 vjeçare
  - c) Në moshë prej 10-14 vjeçare
  - ç) Pas moshës 14 vjeçare
7. Sa shpesh ke kontakte me grupet etnike vijuese në shkollë?  
Nëse është e nevojshme, plotëso edhe grupe tjera.

Rretho sa kontakte ke pasur

Maqedonas.....	shpesh	-	rrallë	-	nuk kam kontakt
Shqiptarë.....	shpesh	-	rrallë	-	nuk kam kontakt
Romë.....	shpesh	-	rrallë	-	nuk kam kontakt
Turq.....	shpesh	-	rrallë	-	nuk kam kontakt
Serbë.....	shpesh	-	rrallë	-	nuk kam kontakt
_____	shpesh	-	rrallë	-	nuk kam kontakt

Mund të rethosh më së tepërmi TRE përgjigje

MOS e përmend grupin tënd etnik!

Mos e rrethogrupin tënd etnik

8. Cili është mendimi yt për deklaratën vijuese? „ Shkollat me përbërje të përzër etnike kontribuojnë për marrëshënie më të mra mes grupeve etnike në vend ?”

- a) pajtohem
- b) nuk pajtohem

9. Vallë ke dëgjuar komente ofenduese nga na e profesorëve tuaj për grupet e tjera etnike?

- a) shpesh
- b) disa herë
- c) asnjë herë

10. Nëse je përgjigjur me SHPESH dhe DISA HERË, vallë ato komente kanë ndikuar në qëndrimin tënd ndaj nxënësve nga grupet tjera etnike?


- a) po
- b) jo

11. Vallë ndjen presion nga bashknxënësit nga grupi zt etnik të mos shoqërohesh me grupet e tjera etnike?

- a) shpesh
- b) disa herë
- c) asnjë herë

12. Sipas ty cilat janë arsyet më të shpeshta për armiqësi (zënka, rrahje e të ngjashme) mes nxënësve nga përkatësi të ndryshme etnike në shkollat?

- a) dallime kulturore siç janë gjuha dhe zakonet
- b) ndikimi i mësuesve
- c) ndikimi partive politike
- ç) nxënës dominant
- d) paragjykimet e nxënësve për grupet tjera etnike
- dh) mënyra e udhëheqjes së shkollës i cili i favorizon një grup etnik të caktuar
- e) ndikimi i gazetave, radioja, TV dhe interneti



13. Si do ta kishe vlerësuar rolin e shkollës tënde në zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndër-etnike?

- a) aktivishti i avancon marrëdhëniet pozitive mes nxënësve nga grupet e ndryshme etnike
- b) ndërmerr masa të caktuara për avancimin e marrëdhënieve pozitive
- c) nuk ndërmerr masa për avancimin e marrëdhënieve pozitive, por duhet të ndërmerr
- ç) nuk ndërmerr masa, për shkak se ka vetëm një grup etnik në shkollë

14. Vallë mendon se në librat shkollor grupi zt etnik është paraqitur drejtë?

- a) po
- b) jo

15. Vallë do të kishe marrë pjesë në aktivitete të organizuara në shkollën tënde, bashkarisht me nxënësit nga grupet e tjera etnike?

- a) po
- b) jo

Të dhëna personaëe:

16. Unë jam: mashkull    femër (rretho)

17. I përkas grupit vijus etnik \_\_\_\_\_

18. Shkolla gjendet në qytet/fshat \_\_\_\_\_

## ARTIKULLI 2 - LISTA E SHKOLLAVE

	LOKACIONI	SHKOLLA	PROFILI	Gjuha/ët e mësimdhënies
1.	Shkup	SGUS “Dimitar Vllahov”	Profesionale	Maqedonisht & shqip
2.	Shkup	ASUC “Boro Petrushevski”	Profesionale	Maqedonisht & shqip
3.	Shkup	SUGS “Josip Broj Tito”	Gjimnaz	Maqedonisht & turqisht
4.	Shkup	SUGS “Zef Lush Marku”	Gjimnaz	Shqip
5.	Shkup	SMUGS “Pançe Karagjozov”	Profesionale	Maqedonisht & shqip
6.	Shkup	DUFK “Metodi Mitevski-Brico”	Profesionale	Maqedonisht
7.	Kumanovë	STU “Nace Bugjoni”	Profesionale	Maqedonisht & shqip
8.	Kumanovë	SOU “Goce Dellçev”	Gjimnaz	Maqedonisht & shqip
9.	Kratovë	SOU “Mitno Penxhukliski”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
10.	Kriva pallankë	SOU “Gjorçe Petrov”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
11.	Sveti Nikole	SOU “Koço Racin”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
12.	Shtip	SOU “Jane Sandanski”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
13.	Shtip	DEMU “Kole Nehetin”	Profesionale	Maqedonisht
14.	Radovish	SOU “Kosta Susinov”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht & turqisht
15.	Strumicë	DSU “Nikolla Karev”	Profesionale	Maqedonisht
16.	Vallandovë	OSU “Goce Dellçev”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
17.	Veles	SOU “Koço Racin”	Gjimnaz	Maqedonisht & shqip
18.	Veles	SSOU “Kole Nedelkovski”	Profesionale	Maqedonisht
19.	Negotinë	SOU “Sh. Qiril dhe Metodij”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
20.	Krushevë	SOU “Naum Naumovski -Borçe”	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht

	LOKACIONI	SHKOLLA	PROFILI	Gjuha/ët e mësimdhënies
21.	Prilep	SOU "Kuzman Josifovski-Pitu"	Profesionale	Maqedonisht
22.	Prilep	SOU "Mirçe Acev"	Gjimnaz	Maqedonisht
23.	Manastir	SOU "Josip Broz-Tito"	Gjimnaz	Maqedonisht & shqip
24.	Manastir	SOU "Taki Daskallo"	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
25.	Manastir	SOUZ "Kuzman Shapkarev"	Profesionale	Maqedonisht
26.	Resnjë	SOU "Car Samoill"	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht & shqip & Turqisht
27.	Demir Hisar	SOU "Krste P. Misirkov"	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
28.	Ohër	OSU "Sh. Klimenti i Ohrit"	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht
29.	Ohër	OUTU "Vanço Pitoshevski"	Profesionale	Maqedonisht
30.	Strugë	SOU "Niko Nestor"	Profesionale	Maqedonisht & shqip
31.	Strugë	SOU "Dr. Ibrahim Temo"	Gjimnaz	Maqedonisht & shqip
32.	Kërçovë	OSU "Mirko Mileski"	Gjimnaz/ profesionale	Maqedonisht & shqip
33.	Dibër	CSNO "Ydravko Çoçkovski"	Gjimnaz	Maqedonisht & shqip
34.	M. Brod	SOU "Sh. Naum Ohridski"	Gjimnaz	Maqedonisht
35.	Gostivar	SOU "Çade Filipovski"	Profesionale	Maqedonisht & shqip & Turqisht
36.	Gostivar	CSNO "Ylate Mallakovski"	Profesionale	Maqedonisht & shqip & Turqisht
37.	Tetovë	SOUT "Gjoce Stojçevski"	Profesionale	Maqedonisht & shqip
38.	Tetovë	OSEU "8 shtatori"	Profesionale	Maqedonisht & shqip
39.	Tetovë	SOU "Kirill Pejçinoviç"	Gjimnaz	Maqedonisht & shqip
40.	Tetovë	SOM "Nikolla Shtejn"	Profesionale	Maqedonisht & shqip & Turqisht

### ARTIKULLI 3 - TABELA

Tabela 1. Në çfar moshe u bëre i/e vetëdhëm/ me për jetesën e grupeve të ndryshme etnike në vend?

	Pa përgjigje	Në moshë 2-5 vjeçare	Në moshë 6-9 vjeçare	Në moshë 10-14 vjeçare	Pas moshës 14 vjeçare	Gjithsej
Maqedons/e	7	220	1062	942	409	2640
%	,3%	8,3%	40,2%	35,7%	15,5%	100,0%
Shqiptar/e	6	138	452	278	139	1013
%	,6%	13,6%	44,6%	27,4%	13,7%	100,0%
Turk/e	2	51	96	24	26	199
%	1,0%	25,6%	48,2%	12,1%	13,1%	100,0%
Tjerë	0	26	62	55	37	180
%	,0%	14,4%	34,4%	30,6%	20,6%	100,0%
Gjithsej	15	435	1672	1299	611	4032
%	,4%	10,8%	41,5%	32,2%	15,2%	100,0%

Tabela 2: Çka kontriboi të bëhesh i/e vetëdijshëm/me për ekzistimin e grupeve të ndryshme etnike

	shokë	prindë	mësues	media	libra	bashknxënës	tjerë	gjithsej
<b>Maqedonas/e</b>	989	1864	898	1644	393	377	67	6232
<b>%</b>	15,9%	29,9%	14,4%	26,4%	6,3%	6,0%	1,1%	
<b>Shqiptar/e</b>	465	770	454	412	180	93	16	2390
<b>%</b>	19,5%	32,2%	19,0%	17,2%	7,5%	3,9%	,7%	
<b>Turk/e</b>	94	122	75	74	33	29	5	432
<b>%</b>	21,8%	28,2%	17,4%	17,1%	7,6%	6,7%	1,2%	
<b>Tjerë</b>	87	110	49	93	30	22	2	393
<b>%</b>	22,1%	28,0%	12,5%	23,7%	7,6%	5,6%	,5%	
<b>Gjithsej</b>	1635	2866	1476	2223	636	521	90	9447
<b>%</b>	17,3%	30,3%	15,6%	23,5%	6,7%	5,5	0,9%	

Tabela 3: Grupi etnik për të cilin kanë ndjenja pozitive

	maqedonas	shqiptarë	Turq	Romë	Serb	boshnjakë	Vllehtë	Maqedonas musliman	Asnjë	Të gjithë	Tjerë	gjithsej
<b>Maqedonas/e</b>	41	263	540	348	804	56	172	35	140	110	116	2008
<b>%</b>	2,0%	13,1%	26,9%	17,3%	40,0%	2,8%	8,6%	1,7%	7,0%	5,5%	5,8%	
<b>Shqiptar/e</b>	226	15	397	71	30	61	12	11	1	15	17	685
<b>%</b>	33,0%	2,2%	58,0%	10,4%	4,4%	8,9%	1,8%	1,6%	,1%	2,2%	2,5%	
<b>Turk/e</b>	83	74	3	9	9	13	1	0	1	4	5	147
<b>%</b>	56,5%	50,3%	2,0%	6,1%	6,1%	8,8%	,7%	,0%	,7%	2,7%	3,4%	
<b>Tjerë</b>	350	352	940	428	843	130	185	46	142	129	138	2840
<b>%</b>	12,3%	12,4%	33,0%	15,1%	29,6%	4,6%	6,5%	1,6%	5,0%	4,5%	4,8%	

Tabela 4: Moshë e zhvillimit të ndjenjave pozitive

	Pa përgjigje	Në moshë 2-5 vjeçare	Në moshë 6-9 vjeçare	Në moshë 10-14 vjeçare	Pas moshës 14 vjeçare	Gjithsej
<b>Maqedonas/e</b>	624	103	501	857	555	2640
<b>%</b>	23,6%	3,9%	19,0%	32,5%	21,0%	100,0%
<b>Shqiptar/e</b>	256	44	181	320	212	1013
<b>%</b>	25,3%	4,3%	17,9%	31,6%	20,9%	100,0%
<b>Turk/e</b>	48	16	57	54	24	199
<b>%</b>	24,1%	8,0%	28,6%	27,1%	12,1%	100,0%
<b>Tjerë</b>	56	17	32	44	31	180
<b>%</b>	31,1%	9,4%	17,8%	24,4%	17,2%	100,0%
<b>Gjithsej</b>	984	180	771	1275	822	4032
<b>%</b>	24,4%	4,5%	19,1%	31,6%	20,4%	100,0%

Tabela 5: Grupi etnik për të cilin kanë ndjenja pozitive

	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë	Serb	Boshnjakë	Vllehtë	Maqedonas musliman	asnjë	Të gjithë	tjerë	gjithsej
<b>maqedonas/e</b>	9	1225	153	356	17	33	21	14	234	14	207	2283
<b>%</b>	,4%	53,7%	6,7%	15,6%	,7%	1,4%	,9%	,6%	10,2%	,6%	9,1%	
<b>Shqiptar/r</b>	326	41	54	155	251	1	6	0	4	0	29	867
<b>%</b>	37,6%	4,7%	6,2%	17,9%	29,0%	,1%	,7%	,0%	,5%	,0%	3,3%	
<b>Turk/e</b>	11	45	0	11	21	2	0	0	15	0	5	110
<b>%</b>	10,0%	40,9%	,0%	10,0%	19,1%	1,8%	,0%	,0%	13,6%	,0%	4,5%	
<b>Tjerë</b>	3	52	9	14	2	3	1	2	16	0	8	110
<b>%</b>	2,7%	47,3%	8,2%	12,7%	1,8%	2,7%	,9%	1,8%	14,5%	,0%	7,3%	
<b>Gjithsej</b>	349	1363	216	536	291	39	28	16	269	14	249	3370



Tabela 6: Moshë e zhvillimit të ndjenjave negative

	Pa përgjigje	Në moshë 2-5 vjeçare	Në moshë 6-9 vjeçare	Në moshë 10-14 vjeçare	Pas moshës 14 vjeçare	Gjithsej
Maqedonas/e	803	99	389	805	544	2640
%	30,4%	3,8%	14,7%	30,5%	20,6%	100,0%
Shqiptar/e	265	60	186	255	247	1013
%	26,2%	5,9%	18,4%	25,2%	24,4%	100,0%
Turk/e	95	8	37	36	23	199
%	47,7%	4,0%	18,6%	18,1%	11,6%	100,0%
Tjerë	83	12	24	29	32	180
%	46,1%	6,7%	13,3%	16,1%	17,8%	100,0%
Gjithsej	1246	179	636	1125	846	4032
%	30,9%	4,4%	15,8%	27,9%	21,0%	100,0%

Tabela 7: Frekuenca e kontakteve me grupet tjera etnike në shkollë

	Maqedonas			Shqiptarë			Turq			Romë		
	Shpesh	Rrallë	Nuk ka kontakt	Shpesh	Rrallë	Nuk ka kontakt	Shpesh	Rrallë	Nuk ka kontakt	Shpesh	Rrallë	Nuk ka kontakt
Maqedonas/e				395	876	1086	500	989	882	359	1068	915
%				16,8%	37,2%	46,1%	21,1%	41,7%	37,2%	15,3%	45,6%	39,1%
Shqiptar/e	332	375	113				152	345	264	66	202	451
%	39,8%	46,3%	14,0				20,0%	45,3%	34,7%	9,2%	28,1%	62,7%
Turk/e	116	50	9	78	51	32				29	50	61
%	66,3%	28,6%	5,1%	48,4%	31,7%	19,9%				20,7%	35,7%	43,6%
Tjerë	113	8	1	24	61	55	22	52	57	26	56	48
%	92,6%	6,6%	0,8%	17,1%	43,6%	39,3%	16,8	39,7%	43,5%	20,0%	43,1%	36,9%

Tabela 8: Pajtueshmëri me deklaratën: Shkollat me përbërje të përzier etnike kontribuojnë për marrëdhënie më të mira mes grupeve etnike në vend

	Pajtohem	Nuk pajtohem	Gjithsej
Maqedonas/e	1488	1124	2612
%	57,0%	43,0%	100,0%
Shqiptar/e	680	320	1000
%	68,0%	32,0%	100,0%
Turk/e	148	43	191
%	77,5%	22,5%	100,0%
Tjerë	115	63	178
%	64,6%	35,4%	100,0%
Gjithsej	2431	1550	3981
%	61,1%	38,9%	100,0%

Tabela 9: Frekuenca e dëgjuarjes së komenteve ofenduese nga ana e mësuesve për grupet tjera etnike

	Shpesh	Disa herë	Asnjë herë	Gjithsej
Maqedonas/e	110	1047	1471	2628
%	4,2%	39,8%	56,0%	100,0%
Shqiptar/e	98	443	466	1007
%	9,7%	44,0%	46,3%	100,0%
Turk/e	14	103	82	199
%	7,0%	51,8%	41,2%	100,0%
Tjerë	24	71	84	179
%	13,4%	39,7%	46,9%	100,0%
Gjithsej	246	1664	2103	4013
%	6,1%	41,5%	52,4%	100,0%

Tabela 10: Frekuenca të ndjenjurit të presionit mbi bashknxënësit të mos shoqërohen me grupet tjera etnike

	Shpesh	Disa herë	Asnjë herë	Gjithsej
<b>Maqedonas/e</b>	142	823	1647	2612
<b>%</b>	5,4%	31,5%	63,1%	100,0%
<b>Shqiptar/e</b>	111	400	490	1001
<b>%</b>	11,1%	40,0%	49,0%	100,0%
<b>Turk/e</b>	8	54	133	195
<b>%</b>	4,1%	27,7%	68,2%	100,0%
<b>Tjerë</b>	13	72	92	177
<b>%</b>	7,3%	40,7%	52,0%	100,0%
<b>Gjithsej</b>	274	1349	2362	3985
<b>%</b>	6,9%	33,9%	59,3%	100,0%

Tabela 11: Shkaqe për armiqësi (zënka, rrahje) mes nxënësveve prej bashkësive të ndryshme etnike në shkollë

	Dallime kulturore	Ndikimi i mësuesve	Ndikimi i partive politike	Nxënës dominant	Paragjykimet e nxënësve	Mënyra e udhëheqjes së shkollës	Ndikimi i mediave	Gjithsej
<b>Maqedonas/e</b>	1078	270	1146	726	1233	498	658	2601
<b>%</b>	41,4%	10,4%	44,1%	27,9%	47,4%	19,1%	25,3%	
<b>Shqiptar/e</b>	505	148	416	296	307	319	203	987
<b>%</b>	51,2%	15,0%	42,1%	30,0%	31,1%	32,3%	20,6%	
<b>Turk/e</b>	86	31	92	42	82	39	33	192
<b>%</b>	44,8%	16,1%	47,9%	21,9%	42,7%	20,3%	17,2%	
<b>Gjithsej</b>	1669	449	1654	1064	1622	856	894	3780
<b>%</b>	44,2%	11,9%	43,8%	28,1%	42,9%	22,6%	23,7%	100,0%

Tabela 12: Vallë mendon se në librat shkollore grupi yt etnik është paraqitur drejtë

	Po	Jo
<b>Maqedonas/e</b>	2083	511
<b>%</b>	80,3%	19,7%
<b>Shqiptar/e</b>	549	426
<b>%</b>	56,3%	43,7%
<b>Turk/e</b>	111	86
<b>%</b>	56,3%	43,7%
<b>Tjerë</b>	113	59
<b>%</b>	65,7%	34,3%
<b>Gjithsej</b>	2856	1082
<b>%</b>	72,5%	27,5%

Tabela 13: Vallë do të kishe marrë pjesë në aktivitete të organizuara në shkollën tënde, bashkë me nxënësit nga grupet tjera etnike?

	Po	Jo
<b>Maqedonas/e</b>	2084	518
<b>%</b>	80,1%	19,9%
<b>Shqiptar/e</b>	829	159
<b>%</b>	83,9%	16,1%
<b>Turk/e</b>	136	56
<b>%</b>	70,8%	29,2%
<b>Tjerë</b>	137	36
<b>%</b>	79,2%	20,8%
<b>Gjithsej</b>	3186	769
<b>%</b>	80,6%	19,4%

